

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deputetët mblidhen sërish të enjten, demokratët e socialistët “përballen” me njëri-tjetrin, qytetarët do i pr esin me vezë në duar (DETAJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/te-enjten-kuvend-zbardhet-rendi-i-dites-pese-perballje-mes- socialisteve-i401284
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 18:05:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:03:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cb34fbbb5f3341f37f9488416c2dd795c38c35f28e4cf7aac70aa2b19ec36268
TEKSTI	04bdc8efccd3177897127e21bc753067c5311e52f920ac4ce77d0279efd9eba2
PAMJA	fbc6f1f786ee4228b22b297d9af3472b7d5de8317e24af3d4d3aa87c0ad1fe89

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76135a05d9bbeeb16c4ac6455c81499de2eca98daa76a95aa2841ef46d52bb5f
E MËPARSHMJA	450e199e2bcf443ef6b4dd0d0f77bbbab3eabc9016ae34043939d01a71138e57
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/76135a05d9bbeeb16c4ac6455c81499de2eca98daa76a95aa2841ef46d52bb5f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

15 Shtator 2026, 20:03

Deputetët mbledhen sërish të enjten, demokratët e socialistët "përballen" me njëri-tjetrin, qytetarët do i presin me vezë në duar (DETAJE)



Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim: Salla e Kuvendit dhe protestuesit para institucionit

Si zakonisht, të enjten e kësaj jave pritet të zhvillohet seanca e radhës parlamentare, ndërsa janë zbuluar dhe punimet që do të zhvillohet.

Referuar rendit të ditës mësohet se seanca do të nisë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 8 shtator, ndërsa pritet të zhvillohet dhe parashikuar pesë interpelanca urgjente të kërkuara nga demokratët.

Interpelanca e parë pritet të zhvillohet me Ministrin e Mjedisit, Sofjan Jaupaj, e dyta me Ministrin e Punëve të Brendshme dhe interpelancat e tjera do të mbahen me Ministren e Arsimit, Mirela Kumbaro dhe Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu.

Gjithashu mësohet se deputeti Blendt Himçi ka kërkuar "të përballen" me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi. Ky i fundit të premten që lamë pas, pas mbylljes së mbledhjes së qeverisë bëri me dije se në këtë seancë do të marrin përgjigje pyetje të shumta në lidhje me përmbushjen e detyrave të ministrisë që ai drejton. Megjithatë, pritet për t'u parë nëse do të jetë i pranishëm apo jo të enjten në Kuvend.

Po ashtu, në vijim të seancës që do të zhvillohet të enjten, deputetët do të shqyrtojnë një sërë projektligjesh, mes tyre projektligjin për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, të bërë në Hagë më 16 dhjetor 2025. Në rend dite përfshihet dhe projektligji për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Nga fusha në tregun evropian, Ministri i Bujqësisë: Toka mbetet e jotja, makineritë dhe tregu të përbashkëta



Rajoni

TRAGJEDI në Venecia! Aksidenti me varkë "u pret jetën në mes" çlirët të sapomartuar, e reja shtatëzënë gjendet pas tre ditësh në ujërat e ftohta

Zbulu më shumë artikuj >

te Evropës për Intelligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës.

Ndërkohë, qytetarët janë bërë sërish bashkë në ditën e 108-të para Kryeministrit, ku kërkojnë me këmbëngulje ndryshim të klasës politike. Ndërsa kanë njoftuar se në orën 10 të mëngjesit të së enjtes, ata do të jenë sërish bashkë para Parlamentit duke pritur me vezë në duar deputetët.

"Ditën e enjte parlamenti i krimit rimblidhet me urgjencë për të kaluar 5 ligje që kanë për grabitjen e shqiptarëve. Ndaj atje janë kriminelët, tradhtarët. Ditën e enjte ora 10: të gjithë te Parlamenti i krimit", njoftoi aktivisti Arben Kola në protestën e sotme.

Rendi i ditës:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KRYETARI**

Nr. 4011 Prot.

Tiranë, më 18.09.2026

URDHËR

Nr. 54, datë 15.9.2026

**PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE NË DATËN 17.9.2026,
ORA 10:00**

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, dhe nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 7 – 25 shtator 2026,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 17.9.2026, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8.9.2026.
 2. Njoftime.
 3. Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
 4. Interpelancë urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
 5. Interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit, znj. Mirela Kumbaro, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
 6. Interpelancë urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Klodiana Spahiu, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
 7. Interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Enea Karakaçi, kërkuar nga deputeti Blendi Himçi.
 8. Projektligji "Për ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën, bërë në Hagë, më 16.12.2025".
 9. Projektligji "Për ratifikimin e Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për Intelligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës".

10. Projektligji "Për pranimin e vendimit DEC-I 1/119-VI/2024, të Këshillit të Anëtarëve të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, për ndryshimin e nenit 36 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjë e Tavolinës, 2015, aderuar me ligjin nr. 112/2017".
11. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".
12. Projektligji "Për disenjot".
13. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10236, datë 18.2.2010, "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike".
14. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 85/2026, "Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit".
15. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 86/2026, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit".
16. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 87/2026, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit".
17. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 19:29 Newsbomb

Edi Rama dhe Sali Berisha kalojnë sërish oqeanin, kryeministri do takohet dhe me diasporën shqiptare, pritjet të dekorohet me çmim nga Trump (DATAT-DETAJE)



Politikë

Albin Kurti për herë të katërt kryeministër, Edi Rama i shkruan letër: Jam gati për bashkëpunim të gjithanshëm, mirë se të vish në Tiranë



Politikë

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn, reagon Edi Rama: Unë e respektoj vendimin, por Tirana është pa kokë dhe askush s'do t'ia dijë për 1 milionë banorët e kryeqytetit



E Mërtë 14:37

Nafta 229 lekë, më shtrenjtë se në gjithë rajonin, PD akuza Qeverisë: Faji nuk është i luftës, por regjimi i Edi Ramës na vjedh me rritjen e taksave



Politikë

Berisha u takua me kongresmenët amerikanë, Evi Kokalari tregon prapaskenat e bujshme: U sponsorizuan nga pronari i klubit të striptizimit, mik i Mediut

E Mërtë 13:12



Politikë

Gjykata e Lartë la në burg Erion Veliqin, Plarent Ndreca i shqetësuar për demokracinë e vendit: Pasojat prekin qytetarët, do e ndjekim edhe më tej

E Mërtë 12:08



E Mërtë 11:57

Kryeministri Rama në Napoli, vizitë në Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale"





Politikë

Ndërtimi i paligjshëm pengon vendosjen e ashensorit në pallatin ekzistues, Braçer akuza IMT-së dhe UKT-së: Më "shitën" se mbrojnë paligjshmërinë


E Martë 11:37



Politikë

Shuhen shpresat për Erion Vellajn, Gjykata e Lartë e lë në burg

E Martë 11:06



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.